



# ISO = POLIFONIA

JANAR 2006, NR. 1

Botimi i Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF-it  
Realizuar në bashkëpunim me stafin e gazetës "Dita JUG"

## Iso-Polifonia, shpallet kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit

### EDITORIAL

#### Iso-Polifonia, vlerësimi edhe angazhimi ynë

Nga Niko MIHALI\*

**D**ata 25 nëntor e vitit që shkoi shënon një eveniment të rëndësishëm për mozaikun e jetës kulturore shqiptare. UNESCO, kreshta më e lartë e kulturës botërore, pasi diskutoi propozimin dhe dosjen e dërguar nga Shqipëria për Iso Polifoninë, e miratoi atë si një "kryevepër të trashëgimisë gojore të njerëzimit" dhe jep ndihmesën e saj për mbrojtjen e kësaj vlere unike shqiptare duke e radhitur atë krahas kulturave të tjera botërore.

Brenda një kohe të shkurtër, pas miratimit të Parkut Arkeologjik të Butrintit dhe qytetit të gurtë të Gjirokastrës, është pikërisht isopolifonia jonë që bëhet pjesë e këtyre vlerave dhe ndërkohë shënon një angazhim shumë serioz nga gjithë aktorët e jetës shqiptare që në veprimtarinë e tyre të përditshme fokusojnë edhe isopolifoninë.


Ishte pikërisht shteti shqiptar, strukturat, organet dhe institucionet e tij kulturore dhe shkencore, në mënyrë të veçantë ishte Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, që për një kohë të gjatë kanë mbajtur lidhje të ngushta me UNESCO-n për prezantimin e këtyre vlerave, që kanë përgatitur dosje të tëra me dëshmi e fakte shkencore dhe historike të cilat krijuan bindshëm mendimin se këto perla të muzikës popullore shqiptare janë njëkohësisht edhe vlera të kulturës botërore. Në fund të fundit, në atmosferën e proceseve integruese, një eveniment i tillë na bën krenar sepse edhe ne

shqiptarët kemi se ç'farë t'i tregojmë mbarë njerëzimit.

Gazeta "Iso-Polifonia" që merr rrugë sot me numrin e saj të parë ka marrë përsipër që në faqet e saj të pasqyrojë dhe raportojë atë çka ndodh sot realisht në jetën kulturore shqiptare për ruajtjen dhe konservimin e kësaj vlere, për pasqyrimin e të gjitha veprimtarive kulturore e shkencore në dobi të isopolifonisë. Janë me dhjetra e qindra institucionet, grupet e shoqatat kulturore në gjithë Shqipërinë dhe kryesisht në rajonet jugore të saj, ku mbarret me fanatizëm dhe kultivohet me dashuri kjo muzikë orgjinale. Atë e kanë mbajtur të gjallë qysh prej lashtësisë qindra mijëra veprimtari të ndryshme familjare, individuale dhe publike. Këngët polifonike, të shoqëruara me iso apo edhe me instrumenta popullore, vazhdojnë të jenë pjesë e jetës kulturore shqiptare, e koncerteve dhe programeve radiofonike dhe televizive.

Festivalet folklorike kombëtare dhe lokale që orga-

**Vijon në faqen 2**



#### Rruga e iso-polifonisë drejt UNESCO-s

Nga Prof. Dr. Vasil S. Tole

Pa më të voglin dyshim, data 25 nëntor 2005 është një ditë historike për mbarë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve, por dhe për vetë Shqipërinë. Në këtë ditë "Iso-polifonia

popullore shqiptare" përfshihet plot dinjitet në listën e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO. Ky lajm i madh për kulturën dhe historinë mbarë shqiptare u kumtua në të gjitha mediat e botës

nga vetë Dr. Koichiro Matsuura, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, nga selia qendrore e UNESCO-s në Paris. Për të dale me këtë vendim, Juria Ndërkombëtare e mbledhur në Paris...

**faqe 3**

#### OPINION

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, Koichiro Matsuura

E vendosur në një kryqëzim kulturash që kanë shfaqur influencën e tyre ndër shekuj, Shqipëria paraqet një tablo muzikore me një varietet jo të zakonshëm e cila i ka mbijetuar periudhave të ndryshimit dhe trazirave politike duke i ofruar gjeneratës së sotme një mënyrë për të konfirmuar identitetin e tyre kulturor.



Në foto: Grupi i polifonik "Ergjëria" në kalanë e Gjirokastrës.

Foto "Dita JUG"



## STAFI I GAZETËS ISO-POLIFONIA

"Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony"

"Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit"

"A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity"

Organ i përmuajshëm i Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës IMC/UNESCO dhe seksionit Shqiptar të CIOFF-it. Gazeta botohet në qytetin muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

### KËSHILLI BOTUES

KRYETAR NDERI: Prof. Ramadan Sokoll

KRYETAR I KËSHILLIT BOTUES:

Prof. Dr. Vasil S. TOLE.

ANTARË:

Akademik Jorgo Bulo, Prof. Dr. Fatmir Hysli, Prof. Agron Xhagolli, Prof. Spiro Shituni (USA), Dr. Eno Koço (Angli), Prof. As. Josif Minga, Bardhyl Londo, Aleks Todhe.

DREJTOR: Niko Mihall.

KRYEREDAKTOR: Engjëll Serjani.

KOLEGJIMI I REDAKSISË:

Arian Avrazi, Ilir Dhuri, Lefter Cipa, Muhamet Tartari, Sejmen Gjokoll, Maks Kulo, Thanas Dino, Shkëlqim Hajno, Shkëlqim Guçe.

Art-Design: Klidi Proko.

Kontakt: Këshilli i Muzikës Shqiptare  
e-mail: tole@isopolifonia.com  
Mob: 0 68 21 55551

Seksioni shqiptar i Cioff-it:

E-mail: egjikassoc@albbmail.com  
Cel: 0 69 22 34986

Gazeta "Iso polifonia-Albanian Folk Iso Polyphony":

E-mail: ditajug@yahoo.com  
Cel: 068 22 04502



Këshilli i Muzikës Shqiptare-KMSH është person juridik i regjistruar pranë Gjykatës së rrethit Tiranë me nr. Akti 3074, me vendimin nr. 1784. K.M.SH-Albanian Music Council zyrtarisht njihet si Komiteti Nacional i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC)-UNESCO, në Shqipëri. (CIM/49.631).

# Konfirmim i identitetit shqiptar

Opinion i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s për projektin "Trashëgimia Shpirtërore Shqiptare"



Nga Koichiro MATSUURA

Evropa Jug-Lindore është e njohur për një larmi kulturore dhe një trashëgimi të pasur, shpirtërore dhe materiale, kur ndërkohë pjesa më e madhe e saj duhet akoma të zbulohet nga bota e jashtme. Muzika tradicionale është një nga shtyllat kryesore të kësaj trashëgimie.


E vendosur në një kryqëzim kulturash që kanë shfaqur influencën e tyre ndër shekuj, Shqipëria paraqet një tablo muzikore me një varietet jo të zakonshëm, e cila i ka mbijetuar periudhave të ndryshimit dhe trazirave politike duke i ofruar gjeneratës së sotme një

mënyrë për të konfirmuar identitetin e tyre kulturor.

Muzika tradicionale Shqiptare në përgjithësi është e ndarë në dy forma kryesore, të cilat janë paraqitur për së gjalli në këto dy CD: muzika polifonike tipike e krahinës së Jugut, dhe kryesisht monofonika traditë e Veriut. Të dyja këto tradita kanë ngacmuar admirimin e artistëve dhe etnomuzikologëve të përtej kufijve kombëtar.

Ky koleksion i përpiluar në mënyrë mjaft eksperte nga Z.Vasil S. Tole, është atribut i bukurisë dhe karakterit dallues të muzikës Shqiptare. Ajo na çon në një univers të epikave heroike dhe baladave të cilat ripërshkruajnë historinë e vendit; këngë të ëmbla lirike dhe keqardhje të brendshme ose inulla; himne ceremoniale; dhe këngë gazmore gjithashtu.

Në foto: (Iart) Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO, Koichiro Matsuura, (majtas) Kopertina e librit të muzikologut V.Tole.



Instrumentat e në përbërje të këtyre CD-ve përfshijnë lahutën dhe ciftelinë

Ky projekt është një përmbledhje e cmuar e UNESCO-s në promovimin e muzikës tradicionale. Organizata është me shumë se kurrë e dedikuar në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore. Një detyrë e tillë mund të arrihet vetëm nëpërmjet një partneriteti të ngushtë me njerzit dhe

komunitetet të cilët shpesh presojnë të ruajnë pre-jardhjen e identitetit të tyre kulturor duke përdorur traditën orale dhe pasqyrimin artistik të të gjitha llojeve. Kjo përzgjedhje e muzikës tradicionale shqiptare ngre një cep të vellores e cila për një periudhë të gjatë ka fshehur një trashëgimi muzikore të madhe.

Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO

## EDITORIAL

### Iso-Polifonia, vlerësimi edhe angazhimi ynë

vijon nga faqja 1

nizohen në qytetin e Gjirokastrës, Vlorës, Përmetit, etj, nuk mund ta konceptojnë repertorin e tyre pa praninë e këngëve polifonike.

Në tregun muzikor shqiptar janë me dhjetra e qindra kasetat, disqet, CD, dhe DVD me regjistrime të grupeve polifonike, janë me qindra orë programë televizive që trasetojnë në mënyrë të përhershme pjesë nga ky arkiv me vlera të paçmuara, ndërkohë që shumë vlera të tjera të polifonisë presin të zbulohen, evidentohen, studiohen dhe të shohin dritën e rregjistrimit, publikimit dhe hedhjes në qarkullimin e vlerave aktuale muzikore.

Shpallja "kryevepër të trashëgimisë gojore të njerëzimit" e isopolifonisë shqiptare është veç të tjerave edhe një vlerësim për kontributin dhe punën e dhjetra shkencëtarëve, studiuesve, drejtuesve të grupeve polifonike në gjithë Shqipërinë, e qindra bartësve të këtij folklori të rrallë, dhjetra rapsodeve e këngëtarëve të talentuar që kanë mundur të mbajnë gjallë këtë diamant kulturor dhe që me dashuri e pasion e kanë transmetuar nga brezi në brez. Ata janë edhe garancia jo vetëm e rritjes por edhe e pasurimit me vlera të reja.

Në këtë kontekst nuk kemi si të mos kujtojmë kon-

Misioni i gazetës është të pasqyrojmë përpjekjet që bëhen nga bartësit aktualë në trevat e polifonisë, të evidentojmë projektet studimore shkencore, të gjurmë prurjet e reja, të inkurajojmë organizimin e veprimtarive që e mbajnë gjallë polifoninë dhe të nxitim angazhimin e grupeve polifonike, studiuesve, shoqatave e institucioneve për ruajtjen dhe pasurimin.

tributet në ruajtjen e polifonisë shqiptare të Beniamin Krutës, Neço Mukës, Xhevat Avdallit, Mentor Xhemalit, Afize Leskovikut, Demir Zykos, e shume të tjerë që vazhdojnë edhe sot të interpretojnë në skena të Shqipërisë dhe të botës këngët magjike të polifonisë shqiptare. Autorë, udhëtarë e studiues të huaj, në kohë të ndryshme janë befasuar nga këngët e vallet shqiptare të trevave jugore ku palët e fustanellave dhe harmonia e zërave melodiozë merrnin izon e ashpër të maleve të thepisura dhe butësinë e vleve të detit.

Pranimi ndërkombëtar i kësaj vlere unike të kulturës sonë kombëtare, padyshin që do të ndikojë tek institucionet kulturore, grupeve polifonike, shoqatat kulturore që në punën e tyre të reflektojnë më shumë e më mirë për zbulimin dhe pasurimin e kësaj tradite të lashtë.

Mundësitë për hulumtim shkencor pas pranimit të polifonisë në tempullin e kulturës botërore, janë edhe më të mëdha. Krijohen kështu më shumë mundësi për inkurajim moral dhe mbështetje financiare për projektet në dobi të kërkimeve shkencore dhe zhvillimit të veprimtarive në fushën e polifonisë.

Gazeta jonë "Iso-polifonia", është një nismë private e dy shoqatave kombëtare, Këshillit të Muzikës Shqiptare dhe Seksionit Shqiptar të CIOFF, të cilat paralelisht punojnë për forcimin e rrjetit të shoqatave të polifonisë. Misioni ynë është i qartë, të pasqyrojmë përpjekjet që bëhen nga bartësit aktualë në trevat e polifonisë, të evidentojmë projektet studimore shkencore, të gjurmë prurjet e reja, të inkurajojmë organizimin e veprimtarive që e mbajnë gjallë polifoninë dhe të nxitim angazhimin e grupeve

polifonike, studiuesve, shoqatave e institucioneve për ruajtjen dhe pasurimin. Në këtë iniciativë ne do të ftojme për bashkëpunim dhe partneritet institucionet kërkimore shkencore shtetërore, akademike dhe universitare, veçanërisht, Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë e Sporteve, Qendrën Kombëtare të Organizimit të Veprimtarive Folklorike, organet e pushtetit vendor si dhe institucione të tjera.

Gazeta "Iso-Polifonia" jo rastësisht botohet në qytetin e Gjirokastrës, kryeqytetin e folklorit dhe polifonisë dhe njëkohësisht edhe qytet në mbrojtje të UNESCO-s, një shembull i rrallë për ruajtjen dhe vlerësimin e traditave të lashta dhe një model i përkryer për bashkëpunim në promovimin e kësaj tradite.

Gazeta "Iso-Polifonia" më në fund mbrrin tek lexuesi i saj me ftesën për bashkëpunim me të gjithë artistët, bartësit dhe dashamirët e polifonisë. Afrouni tek ne! Bëhuni pjesë e gazetës me idetë, mendimet dhe shkrimet tuaja në rubrikat që ne do ofrojmë për të gjithë!

E paçim rrugën të mbarë!

\* Drejtor i gazetës "Iso-polifonia" dhe Kryetar i Seksionit Shqiptar të CIOFF dhe rrjetit të shoqatave të polifonisë.



# Rruga e iso-polifonisë drejt UNESCO-s në Paris



*Si dhe pse u shpall Iso-polifonia shqiptare kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit?*



**Nga Prof. Dr. Vasil S. Tole \***

Pa më të voglin dyshim, data 25 nëntor 2005 është një ditë historike për mbarë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve, por dhe për vetë Shqipërinë. Në këtë ditë "Iso-polifonia popullore shqiptare" përfshihet plot dinjitet në listën e "Kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO. Ky lajm i madh për kulturën dhe historinë mbarë shqiptare u kumtua në të gjitha mediat e botës nga vetë Dr. Koichiro Matsura, Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, nga selia qendrore e UNESCO-s në Paris. Për të dale me këtë vendim, Juria Ndërkombëtare e mbledhur në Paris nga data 21-24 Nëntor 2005, shqyrtoi mbi 60 kandidatura të propozuara për t'u përfshirë në listën "Kryevepër e njerëzimit", propozime të bëra në rrugë zyrtare nga shtete të ndryshme në çdo anë të botës duke plotësuar dosjet dhe kriteret e shpallura për këtë qëllim.

Juria vendimarrëse përbëhej nga: Dr. Antonio A. ARANTES, President i Institutit Kombëtar Brazilian për Trashëgiminë Historike dhe Artistike, Brazil. H.R.H Basma BINT TALAL, Princesshë e Jordanisë. Aziza BENANINI, Ambasadore e Marokut në UNESCO. Prof. Georges CONDOMINAS, përfaqësues i Francës në UNESCO. Prof. Anzor ERMAICH-VILLI, Profesor në Institutin Kombëtar të Kulturës, Gjeorgji. Carlos FUENTES, përfaqësues i Meksikës në UNESCO. Mister Yoshikazu HASEGAWA, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit për Teatrin e Ri, Japoni. Prof. Epeli HAU'OFA, Drejtor Themelues i Qendrës për Artin dhe Kulturën, Oqeani. Prof. Alpha Oumar KONARE, Kryetar i Komisionit të Bashkimit Afrikan, ish President i Malit. Elvira KUNINA, Drejtore e Shkollës Kombëtare të Artit Folklorik, Rusi. M.s.Olive W.M.LEVIN, Drejtore e të Rinjve, Xhamajkë. Prof. Armandina LIHAMBA, Profesore në Universitetin e Dar El Salamit, Tanzani. Dot.Ahmed MORSI, Kryetar i Bibliotekës dhe



*Përfshirja e Iso-polifonisë në listën e kryeveprave kulturore botërore që mbrohet nga UNESCO, pa asnjë dyshim do të sjellë një njohje dhe përhapje të mëtejshme të kulturës sonë kombëtare në mbarë botën.*

**Në foto:** Autori Vasil S. Tole në mes të pjesëtarëve të grupit polifonik i Lunxhërisë - Gjirokastrë. Foto "Dita JUG"

Librarive Kombëtare, Profesor në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Kajros, Egjipt. Dr. Zhen-tao ZHANG, Profesor në Institutin e Kërkimeve Muzikore në Akademinë e Arteve, Kinë.

Nga 25 Nëntori i vitit 2005 e në vazhdim, "Iso-polifonia" jonë popullore, kjo dukuri e jashtëzakonshme e të konceptuarit dhe e komunikimit njerëzor është vendosur në vendin që meriton: në listën e kryeveprave të botës shpirtërore të njerëzimit. Kjo listë e kryeveprave në thelb përbëhet nga fenomene dhe shfaqje dukurish të kulturave shpirtërore të popujve të ndryshëm të botës të cilat qëndrojnë në themel të kulturës njerëzore, dhe që dallohen për frymën dhe llojin unik që ato përfaqësojnë. Ndër to përmendim: makamet e Irakut, operan e Pekinit, vedat indiane etj. Për të arritur këtë rezultat, u desh të ndiqej një procedurë tepër rigorozë e plotësimit të dosjes së kandidimit të "Iso-polifonisë".

Çfarë përbante dosja e aplikimit në UNESCO?

Dosja e përgatitur nga Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore në MTKRS ishte mbështetur rigorozisht mbi kriteret e shpallura nga UNESCO për aplikim e përbante dhjetra dokumenta shkrimorë, të gjitha në gjuhën angleze, si dhe dhjetra materiale grafike dhe zanore. Ndër materialet dokumentare të dosjes së aplikimit mund të përmendim:

-Kërkesën zyrtare të UNESCO's National Commission of Albania për regjistrimin

e iso-polifonisë si "Masterpiece of the human oral heritage".

-Formulurin e plotësuar të "Albanian folk iso polyphony", fq.1-29. sipas standarteve dhe modelit të UNESCO-s

-Bibliografinë e punimeve të autorëve të huaj mbi iso-polifoninë.

-Bibliografinë e punimeve të autorëve shqiptarë mbi iso-polifoninë.

-Të dhëna dhe botime zyrtare mbi zonat ku këndohet në iso-polifoni.

-Draft Aksion Planin 2003-2008 mbi "Iso-Polifoninë".

-Format e tjera të propozuara siç kërkohet në Formën e Aplikimit Tip.

-Ligjin në gjuhën angleze 9048, dt. 07.04. 2003 "Për trashëgiminë kulturore".

-Studimin e plotë shkencor mbi iso-polifoninë nga Vasil S. TOLE

-Studimin "Odiseja dhe Sirenat, grishje drejt viseve iso-polifonike të Epirit", Uegen, 2005, nga Vasil S. TOLE.

Ndërsa midis materialeve audio, video, grafikave dhe librave të përfshira në dosje janë: Harta të ndryshme të Shqipërisë, plot 32 fotografi me ngjyra së bashku me negativët të grupeve iso-polifonike shqiptare, një dokumentar video me rreth 2 orë film që ilustron të kënduarin iso-polifonik në zonat si më poshtë: a. Himara-Lab iso-polyphony, b. Kolonja-Tosk iso-polyphony, c. Tepele-na-Lab iso-polyphony, d. Gjirokastra-Tosk iso-polyphony, e. Përmeti-Lab iso-polyphony.

Veç të tjerave dosja përfshin një listë të publikimeve audio dhe video që shërbyen si materiale mbështetse si: "Albania Intangible Heritage in CD", Tiranë 2004. Intangible Heritage-Iso-polifonia, Tiranë 2003. The polyphonic group "Kristalet e Smokthinës", Eurostar. The iso-polyphonic group "Djemtë e Vlorës", Eurostar. The polyphonic group "Ergjëria", Eurostar. f. The publication "Popullsia e Shqipërisë" - "Albania's population", Tiranë 2001.

Gjithashtu një video profesionale e tipit (Betacam SP) e titulluar "Albanian Iso-polyphony" me 10 minuta film që pasqyron në mënyrë të përmblodhur elementet më të rëndësishëm të fenomenit muzikor të iso-polifonisë, të përgatitur mbështetur Annex IV, si dhe autorizime dhe dokumenta të tjerë që provojnë orgjinalitetin dhe Copyrightin e materialeve të mësipërme, krijuan imazhin e plotë për vlerat unike orgjinale të iso-polifonisë sonë dhe që bindën plotësisht jurinë ndërkombëtare për këto vlera.

Mbështetur këtij konfirmimi të rëndësishëm për vlerat që mbart trashëgimia shpirtërore shqiptare, mund të themi me plot gojë se kultura shqiptare në tërësi po shndërrohet në faktorin parësor dhe shumë të rëndësishëm integritetit evropian dhe në një imazhit pozitiv për Shqipërinë. Nuk është e pakët që në këto vitet e fundit vetëm në fushën e njohjes ndërkombëtare të vlerave të trashëgimisë kulturore kemi:

Parkun kombëtar të Butrintit, qytetin e Gjirokastrës dhe së shpejti edhe qytetin e Beratit, si "Pasuri kulturore e njerëzimit" mbrojtur nga UNESCO.

Vetë shteti shqiptar ka hartuar dhe implementuar ligje të reja për këtë fushë sic është ai "Për trashëgiminë kulturore"-2003 apo "Për muzetë" 2005, por edhe është bërë gjithashtu pjesë e standarteve globale ndër të tjera edhe duke aprovuar pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare në këtë fushë. Së fundi pritet nënshkrimi aproves formal i konventës së UNESCO-s "Për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore", nga ana e Ministrisë tonë të Jashtëm, mbas Vendimit që mori Këshilli i Ministrave për njohjen në parim të saj tani së fundi. Kësisoj, përfshirja e Iso-polifonisë në listën e kryeveprave kulturore botërore që mbrohet nga UNESCO, pa asnjë dyshim do të sjellë një njohje dhe përhapje të mëtejshme të kulturës sonë kombëtare në mbarë botën. Kjo do të thotë më shumë kujdes dhe fonde për grupet popullore, më shumë support për studimet shkencore për iso polifoninë dhe sigurisht më tepër angazhime për kryerjen e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare që i kushtohen iso-polifonisë, kështj diamanti të kulturës sonë të lashtë.

\* Drejtor i Trashëgimisë Kulturore në MTKRS dhe Eksperti i përgatitjes së dosjes së kandidimit të Iso-Polifonisë



# Leskaj insiston për ruajtjen dhe promovimin e iso-polifonisë

*Iso-polifonia në vëmendje të Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve*

Për ruajtjen, studimin, promovimin dhe popullarizimin mbarëkombëtar të iso-polifonisë si vlerë e pamohueshme e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, që tashmë është pjesë e "Kryeveprave të trashëgimisë orale të njerëzimit", të mbrojtur nga UNESCO, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zoti Bujar Leskaj ka formuluar një udhëzim të veçantë për ruajtjen dhe mbrojtjen e iso-polifonisë shqiptare, me anë të së cilit synon ngritjen në një nivel më të lartë shkencor dhe artistik të punës në drejtim të njohjes e promovimit të vlerave të iso-polifonisë.

Mbi bazën e këtij udhëzimi, Drejtorja e Trashëgimisë Kulturore pranë kësaj ministrie ka rekomaduar dhe propozuar marrjen e disa masave konkrete Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike, administratat e qarqeve Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Fier, Berat, 17 bashki dhe qendra kulturore dhe seksionin e CIOOF-it në Përmet:

Në kuadrin e masave të sipërpërmendura pranë Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do të ngrihet Bordi Këshillimor i Trashëgimisë Shpirtërore Shqiptare, për promovimin dhe menaxhimin e kësaj pasurisë shpirtërore të popullit shqiptar.

Për të ridimensionuar në jetën kulturore vlerat e iso-polifonisë si një pasuri e trashëgimisë shpirtërore botërore, rekomandohet që pranë strukturave të pushtetit vendor në nivel qarku, bashkie dhe komune të krijohen struktura të posaçme brenda strukturave ekzistuese, sikurse mund të jetë caktimi i një specialisti përgjegjës, i cili do të merret me organizimin e veprimtarive dhe propagandimin e dukurive të iso-polifonisë.

Udhëzimi i ministrit Leskaj që mban datën 9 dhjetor 2005 rekomandon qarkun dhe bashkinë



**NË FOTO:**

N/Drejtor i Përgjithshëm i UNESCO-s, Munir Bouchenaki, Ministri TKRS-ve, Bujar Leskaj dhe Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, në ditën e promovimit të pranimit të Gjirokastrës në UNESCO, Shtator 2005.

Foto "Dita JUG"

e qytetit të Vlorës që në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike të organizojnë në qytetin e Vlorës çdo vit në datat 25-28 nëntor, Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë. "Kjo veprimtari e rëndësishme kombëtare të realizohet enkas për ruajtjen, propagandimin dhe kultivimin e traditës muzikore të iso-polifonisë, dhe të organizohet si një veprimtari

multikulturore, ku të përfshihen edhe ekspozita e botimeve kushtuar iso-polifonisë, e CD-ve, videove, etj. me këngë polifonike, tryezave shkencore, etj", nënvizon udhëzimi i ministrit Bujar Leskaj.

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve merr përsipër të mbështetë aktivitetet vendore kushtuar iso-polifonisë, si aktivitete të përvitëshme, ndërkohë

që për mire organizimin e punëve që lidhen me iso-polifoninë dhe koordinimin e tyre me pushtetin qëndror, vendor dhe institucionet e specializuara shkencore, rekomandohet krijimi i "Rrjetit kombëtar të OJQ-ve të iso-polifonisë", iniciativë e cila është duke e konkretizuar nga disa shoqata kulturore në bashkëpunim me Seksionin Shqiptar të CIOOF-it. Qendra Kombëtare e

Veprimtarive Folklorike, përveç organizimit të Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, që zhvillohet çdo vit në qytetin e Vlorës, të parashikojë në buxhetin e saj edhe botime të veçanta për iso-polifoninë dhe dhënieve e çmimeve për CD dhe librin më të mirë kushtuar asaj.

Qendrat Kulturore në qarqet Vlorë, Gjirokastrë, Berat, Korçë, Fier dhe Elbasan, sipas këtij udhëzi-

mi do të angazhohen për organizimin e veprimtarive lokale, ekspozuese në muzetë lokale, shkencore, botuese dhe artistike, kushtuar iso-polifonisë si një vlerë e trashëgimisë shpirtërore botërore.

Kësisoj, Drejtorja e Trashëgimisë Kulturore pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve ka tani më shumë angazhim dhe përgjegjësi për të ndërmarrë iniciativë dhe veprimtari për konservimin, zhvillimin dhe promovimin e vlerave të iso-polifonisë shqiptare, tashmë e shpallur si kryevepër e trashëgimisë kulturore botërore.

Engjëll Serjani



## Bota pranon vlerat tona

*Mendoj që së bashku kemi detyrimin moral dhe artistik për ta trajtuar këtë vlerësim, si një punë të çmueshme duke e bërë gazetën tonë aq të dashur e të vlerësuar sa vetë polifonia jonë.*

**Në foto:** Kompozitori Josif Minga mes instrumentistëve korçar.

Foto "Dita JUG"

Më vjen shumë mirë për momentin e daljes së gazetës "Iso - polifonia" në një qytet si Përmeti, ku trëndafilat kanë mbirë edhe nga zërat e këngëve e bashkë me ngjyrat e tyre kanë lëshuar aromën e dashurisë për jetën. Sigurisht, së pari vlerësoj vendimin në kohë të UNESCO-s për shpalljen "kryevepër të

njerëzimit" të iso-polifonisë sonë, fakt ky që dëshmon për interesin e merituar të kësaj muzike, duke ndriçuar mes kulturave muzikore të vendeve të tjera me origjinalitetin vet. Në këtë rast, duke përfaqësuar këngën polifonike të zonës së Qarkut të Korçës, zemrën e polifonisë toske, nuk ka si të mos ndjehem krenar për këtë trashë-

gimni kaq të vlerësuar, së cilës gjithmonë i detyrohemi për të shpalosur sukseset e saj.

Sigurisht që në këtë mirënjohje kemi përshëndetjen e heshtur të një sërë brezash që me jehonën melodike të tyre do të rizgjojnë me kronikën e tyre shekullore, artistike-muzikore; do të na shfaqen baladat, vajet, këngët e nizamit e të kurbetit, lirikat

e dashurisë, avazet, këngët hokatare e humoristike e deri tek ninullat. Ndaj mendoj që së bashku kemi detyrimin moral dhe artistik për ta trajtuar këtë vlerësim, si një punë të çmueshme duke e bërë gazetën tonë aq të dashur e të vlerësuar sa vetë polifonia jonë.

Më kujtohen këtu fjalët e prof. Rudolf Pietsch, shef i departamentit të etnomuz-

ikologjisë në Vienë, në takimin e fundit të polifonisë se Mesdheut "European Voices", Mars 2005, ku vlerësonte sipas gjykimit të vet: "polifonia juaj ka ndërtim shtresor të çuditshëm, ku konkurrenca brenda zërave, është sa e dukshme aq dhe e padukshme, por që sjell një unitet vertikal-horizontale tepër origjinal dhe të veçantë". Pra, si fund, le të mos lodhemi nga vështirësitë, le të mënjanojmë "shurdhërinë" e pseudo-specialistëve që shfaqen rëndom nëpër gazetë tona, për të nxjerrë në pah vlerat e vërteta, ato vlera që sot po na i njeh bota në mënyrë që ne të shohim më mirë dhe më qartë.

Punë të mbarë stafit organizues!

Kompozitori Prof. As. Josif Minga



Nga Engjëll Serjani\*

Grupi polifonik tradicional i qytetit të Gjirokastrës, i njohur ndryshe edhe si "Grupi i pleqve të Gjirokastrës", ka hurë në historinë e kulturës kombëtare tradicionale si një nga grupet polifonike me interpretimin më autentik, me jetëgjatësinë më të madhe në interpretimin e polifonisë orgjinale gjirokastrite dhe një prej grupeve me repertor të pasur këngësh.

Grupi i pleqve të Gjirokastrës dhe sidomos lideri marrës i tij, furxhiu i njohur gjirokastrit Xhevat Avdallit e ka nisur veprimtarinë e tij artistike qysh në vitet e fundit të Mbretërisë Shqiptare, por kulmin e konsolidimit të tij, veprimtarinë më të dendur interpretative dhe famën e ka shënuar në periudhën nga viti 1950 deri në fillim të viteve '80.

Grupi polifonik i qytetit të Gjirokastrës, që shpesh identifikohet edhe me emrin e marrësit të tij virtuoz "Grupi i Xhevatit", gjatë kësaj periudhe u dallua për një interpretim krejt orgjinal të këngës së shtruar qytetare gjirokastrite, që ndoshta edhe për shkak të vetë moshës së interpretesve të tij, ajo shpesh u cilësua edhe si "këngë pleqërishte".

Në repertorin e gjerë të këngëve polifonike të interpretuara prej grupit në fjalë përfshihen këngë mjaft të njohura historike si "Kurvelsh e Gegëri", "Ç'u mblodhën në Ergjëri", "Birbilentë trembëdhjetë, vanë në litare vetë", kënga për Avni Rustemin "Lule o Avni Morina", "O Gjirokastra më vullë, ç'e bëre Shemo hajdunë", "Te Rrapi në Mashkullorë", "Gjirokastra jonë moj, jo dhe kaq e mirë", si dhe këngët lirike "Ç'ka sokaku që gjemon, o lejmon more lejmon", "Ç'u mbush mali plot me rrush", "O Çajup, o vend i bukur", "Ç'u ngrëç që me natë", "Kur dalin plakat në lëmë, qaj nëno, qaj moj nënë", "Hodha një lule në ferrë", etj. Veç këngëve tradicionale të shtruara gjirokastrite, grupi ka interpretuar edhe avaze të tjera polifonike nga të gjitha trevat e Labërisë.

Grupi polifonik i këngës qytetare gjirokastrite përbëhet nga këngëtarë të njohur si Artisti i Meriuar Xhevat Avdallit, gjithmonë në rolin e marrësit, këngëtarët virtuozë Javer (Lavo) Erindi, Nustret Çarçani, dhe Tolo Njocko në rolin e kthyesave të këngës, Skënder Tushe e Demo Çenko, që luanin në këtë ansambël muzikor rolin e hedhës, si dhe inter-



Në foto: Grupi i Xhevat Avdallit.

## Grupi i Xhevat Avdallit me vullë

### Profili i grupit polifonik të pleqve të Gjirokastrës që mbajti gjallë këngën në vite

pëetues të talentuar të isos si Jonuz Shehu, Haseni Kore, Beaudin Dobi, Kamber Dumdi, Seit Rondo, Reuf Jaupi, Vehip Çarçani dhe Braho Çoçoli, etj. Pararendes të këtyre mbartësve të njohur të polifonisë gjirokastrite, janë këngëtarët e vjetër të këtij qyteti si: Mujo Bebeçi, Kambo Shehu, Avdulla Erindi, Kamber e Jonuz Kasi, Mufit

Lamko, Fejzi Kasi, Mufit Sinani, Selfo Bajo, Fadil Demo, Muharrem Lekloti, etj.

Veçori e grupit të Xhevatit është se për një periudhë kohe ai ka patur si mar-

rëse një grua dhe kjo ka qënë këngëtarja Majnure Kadëna. Ky grup, që kur niste këngën, ngjante sikur niste një bubullimë e gjatë, ka marrë pjesë në shumë veprimtari të rëndësishme folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare duke filluar nga regjistrimet dhe transmetimet radiofonike, kon-



## Polifonia një dëshmi e gjallë e lashtësisë së artit



Nga Prof. Dr. Spiro Shetuni \*

Përfshirja e isopolifonisë në listën e kryeveprave kulturore të trashëgimisë gojore të mbarë njërëzimit dhe dalja në dritë të botimi e një botimi që i përkush-tohet promovimit të këtyre vlerave të lashtësisë artistike muzikore, padyshim, këto janë ngjarje të mëdha kulturore që

duhen nxitur dhe përshëndetur.

Nëse muzika në përgjithësi është një bashkudhetare e përherëshme e çasteve të gëzuara dhe më të trishtuara të njeriut, isopolifonia është një provë dhe dëshmi e artit të hershëm, është një pasqyrë e qartë e aspekteve historike, artistike dhe estetike që i ka rezistuar rrebesheve të kohrave qysh nga fillimet e jetës njerëzore.

Lashtësia e polifonisë, në rrethanat e mungesës së dokumenteve historike, mund të ndriçohet, para se gjithash, nepermjet hulumtimit të lëndës së gjallë muzikore. Por që fillësa e saj i përket një epoke të lashtë, këtë e tregojnë qartë, mes të tjerash, vetë tiparet kryesore individuale, ndertimi i brendshëm veçanërisht ndërtimi modotonal pentatonik i kësaj kulture muzikore - dihet se model pentatonikë janë me te

hershmet në historinë e muzikës popullore botërore. Hershmeri tregon pa dyshim edhe ngjizja e këngës polifonike në raportet e saj kontrastuese intonative, modale, harmonike; ritmike mes linjave të ndryshme muzikore.

Lashtësi parakupton gjithashtu natyrën thjeshtë zanore e saj etj; Por sidoqoftë, origjina dhe kohelindja e polifonisë mbetet ende një çështje e hapur shkencore që kërkon përveç të tjerash edhe egzistencën e një botimi të tillë special ku përveç promovimit të vlerave të polifonisë, të krijohet hapësirat e debatit të hapur shkencor për probleme të ndryshme shkencore që lidhen me prejardhjen e saj.

